



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 dhjetor 2023
Nr.ref.: RK 2305/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI25/22

Parashtrues

Riza Rrustemi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Pml. nr. 460/2021, të 11 janarit 2022**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Riza Rrustemi, nga fshati Banullë, komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 460/2021], të 11 janarit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [PA.1. nr. 749/2021], të 12 tetorit 2021, e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), dhe me Aktgjykimin [P. nr. 446/2020] e 15 prillit 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës, si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 shkurt 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 mars 2022, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin [Nr. GJR. KI25/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe me Vendimin [Nr. KSH. KI25/22] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci, anëtarë.
8. Më 3 mars 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua edhe Gjykatës Supreme.
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

10. Më 14 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e lëndës rezultoi se kundër parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar dy procedura (penale dhe kundërvajtëse) për shkak të parregullsive në punën e subjektit afarist në pronësi dhe nën përgjegjësinë e tij.

Procedura para Inspektorit të Mjedisit të Komunës së Lipjanit

12. Më 29 korrik 2020, pas kallëzimit të qytetarëve, Inspektori i Mjedisit i Komunës së Lipjanit ka inspektuar subjektin afarist të thertores (në tekstin e mëtejshëm: "thertorja") në pronësi të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 5 gusht 2020, pasi kishte konstatuar (përmes inspektimit të 29 korrikut 2020) disa parregullsi në punën e thertores, shërbimi inspektues i dha urdhër parashtruesit të kërkesës të rregullonte gropën septike sipas kushteve të lejes së mjedisit të marrë nga Komuna e Lipjanit dhe ka vendosur tabelat dhe vulat zyrtare në të cilat tregohet se aktiviteti është i mbyllur deri në përgatitjen e gropës septike, sepse gropa septike ekzistuese është e kyçur në kanalizimin e fshatit.
14. Më 10 gusht 2020, Inspektori i Mjedisit i Komunës së Lipjanit doli sërish për të kontrolluar thertoren dhe konstatoi se ishin hequr shenjat dhe vulat zyrtare dhe se thertorja ka vazhduar të funksionojë pa i korrigjuar paraprakisht defektet teknike.
15. Më 16 gusht 2020, Inspektori për Mjedis i Komunës së Lipjanit paraqiti kallëzim kundërvajtës kundër parashtruesit të kërkesës për mosrespektim të masave në kryerjen e veprimtarive të thertores të cilat janë të parapara me lejen mjedisore të lëshuar nga Komuna e Lipjanit.

Procedura penale ndaj parashtruesit në lidhje me kallëzimin penal të 20 gushtit 2020, të Inspektorit të Mjedisit në Komunën e Lipjanit

16. Më 20 gusht 2020, Inspektori i Mjedisit i Komunës së Lipjanit ka paraqitur kallëzim penal kundër parashtruesit të kërkesës për veprën e kryer penale të heqjes apo dëmtimit të vulave apo shenjave zyrtare nga neni 406 par. 1 të KPK-së, vendosur më 5 gusht 2020 nga shërbimi inspektues.
17. Më 23 nëntor 2020, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë [PP. II. nr. 3454/20] kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave apo shenjave zyrtare nga paragrafi 1 i nenit 406 (Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave) të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së.)
18. Më 15 prill 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [P. nr. 446/2020] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të heqjes ose dëmtimit të vulave ose shenjave zyrtare nga paragrafi 1 i nenit 406 të KPRK-së, dhe e dënoi parashtruesin me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro.
19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit [P. nr. 446/2020], të 15 prillit 2021, të Gjykatës Themelore, duke konsideruar se i njëjti është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale,

vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 12 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 749/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [P. nr. 446/2020], e 15 prillit 2021 të Gjykatës Themelore.
21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PA1. nr. 749/2021] të 12 tetorit 2021, të Gjykatës së Apelit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Nga shkresat e lëndës rezulton se në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore nuk i ka caktuar mbrojtje (avokat) as nuk e ka udhëzuar për mundësinë e angazhimit të mbrojtësit gjatë procedurës penale.

Epilogu i procedurës për kundërvajtje ndaj parashtruesit të kërkesës lidhur me kallëzimin për kundërvajtje të 16 gushtit 2020, të Inspektorit për Mjedis në Komunën e Lipjanit

22. Më 18 nëntor 2021, Departamenti për Kundërvajtje i Gjykatës Themelore përmes Aktgjykimit [K. nr. 3099/21] shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për mosrespektimin e masave në kryerjen e aktiviteteve, të cilat janë të parapara me lejen mjedisore për punën e thertores të lëshuar nga Komuna e Lipjanit dhe për këtë i shqiptoi vërejtje gjyqësore. Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj, theksoi se parashtruesit i ka shqiptuar sanksionin në fjalë: “[...] duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese ndaj subjektit afarist gjegjësisht personit përgjegjës, pendimin e të njëjtit për vepër të kundërvajtjes, si dhe që çdo gjobë do të vështirësonte gjendjen ekonomike dhe financiare të tij dhe të anëtarve të familjes. Gjykata duke i shqiptuar një Qortim gjyqësor ka konstatuar se ndaj të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit që i njëjti mos të përsërit vepër të ngjajshme kundërvajtëse”.

Epilogu i procedurës penale ndaj parashtruesit në lidhje me kallëzimin penal të 20 gushtit 2020, të Inspektorit të Mjedisit në Komunën e Lipjanit

23. Më 11 janar 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 460/2021] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme cenon të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 30, 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 34 të Kushtetutës dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon edhe shkelje të disa neneve të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK) dhe të KPRK-së, duke pretenduar zbatimin e gabuar të tyre dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.
26. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 30 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka disa pretendime lidhur me faktin se nuk i është caktuar përfaqësues ligjor në procedurën para gjykatave të rregullta, si në vijim:

(i) “[...] gjykata të njëjtin asnjëherë nuk e ka udhëzuar për të drejtat e tij që të ketë avokat, sespe shihet edhe nga procesverbalet e seancave gjyqësore se i njëjti nuk ka ditur të przentoj mbrojtjen e tij”.

(ii) “Paraqitësi i kërkesës si person laik nuk ka ditur ti shfrytëzon asnjë mekanizëm ligjor për t’u mbrojtur - për shkak se nuk ka qenë i aftë në aspektin e shëndetit dhe të aftësive konkrete për t’u përballur me akuzën”.

(iii) “Gjykata nuk e ka udhëzuar të akuzuarin se ke të drejtë të angazhosh avokat si e drejtë e garantuar me ligj dhe Kushtetutë, sespe i akuzuari, me dëshmitë dhe argumentet e tij, ai nuk ishte në gjendje të kundërshtonte dhe të kontestonte provat dhe akuzën penale”.

27. Për sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson si vijon:

“Aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare (neni 384, par. 1 pika 1.12 të [KPPRK-së], kjo mund të shihet nga përmbajtja e arsyetimit, ku faktet vetëm përmenden e nuk sqarohet përmbajtja e tyre, përkatësisht aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370, par. 4 të KPPRK-së për më tepër në vijim:

Arsyet janë plotësisht të paqarta, ngase egzistojnë në një masë e konsiderueshme kontradiktat e theksuara midis asaj çka paraqitet në arsyet e aktgjykimit, të cilat kundërthënje janë kontradiktore me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit dhe dëshmitarëve në njërin anë, dhe përfundimet e nxjerra nga Gjykatata në anën tjetër.

Përfundimet e pretenduara të gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me provat e administruara, të cilat gojnë në një përfundim tjetër.

Nuk ka analizë thelbësore në raport me institutin e DASHJES. Por analiza e pretenduar është e përgjithësuar, dhe nuk ka mbështetje në veprimet konkrete të raportit volutiv, pa të cilin edhe nuk ka përgjegjësi penale. Mungesa e një analize të tillë, në këtë dimension, paraqet shkelje esenciale të dispozitave procedurale, andaj aktgjykimi i atakuar nuk mund të qëndroj me qenë se përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, janë në kundërshtim me rezultatet nga provat e administruara. Vlerësimi i secilës provë duhet orientuar në atë se cili fakt provohet me te apo cili fakt kontesohet. Mungesa e një analize në këtë rrafsh paraqet shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, që për pasojë tërheq prishjen e aktgjykimit pa u lëshuar në trajtime tjera.

Mungesa e arsyetimit të këtyre fakteve dhe rrethanave, e bën të paqëndrueshëm ligjërisht aktgjykimin dënues, ngase është kontradiktor me fakte, provat dhe bazën ligjore dhe të padrejtë në administrimin e drejtësisë”.

28. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson:

“Të tri shkallët e gjykatave kanë bërë shkelje të dispozitës së nenit 4 të KPPRK-së, sepse Rizah Rrustemi për të njëjtën vepër është dënuar 2 herë nga Gjykata dhe atë një dënim me vërejtje gjyqësore nga Gjykata Themelore në Prishtinë -Dega në Lipjan-Divizioni Kundërvajte, ku ndaj meje janë përdhur të njëjtat prova-procesverbalet e Inspektoratit të Mjedisit të Komunës së Lipjanit. Po ashtu është dënuar edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan-Departamenti i Përgjithëshëm-Divizioni penal në lëndën P, nr. 446/20, të dt. 15.04.2021, dhe ju ka shiqptuar dënim me gjobë në vlerën prej 400.00 eurove, që përbën shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe dispozitave të ligjit penal e

rrjedhimisht edhe shkelje të të drejtave të cilat ja garanton Kushtetuta e Kosovës dhe, dhe konventat evropiane për të drejtat e njeriut”.

29. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës që i referohen shkeljes së nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 10 të DUDNJ-së, parashtruesi i kërkesës nuk e arsyeton shkeljen e këtyre dispozitave, por vetëm i përmend në kërkesën e tij.
30. Parashtruesi i kërkesës në fund kërkon nga Gjykata të konstatojë se vendimi i kontestuar cenon të drejtat e lartpërmendura të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, duke kërkuar konkretisht që:

“TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 460/2021 të dt. 24.01.2022 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAL. nr. 749/2021 dt. 12.10.2021, sepse aktgjykimet nuk janë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

TË KTHERJË rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

TË URDHEROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për përmbarrimin e Aktgjykimit të Gjykatës; TË MBETET e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Neni 30

[Të Drejtat e të Akuzuarit]

“Çdokush që akuzohet për veprën penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;*
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;*
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;*
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;*
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.”*

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]*”

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 34
[E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

“Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]*”

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 10

“Gjithkush ka të drejtën e një dëgjimi të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij dhe të çdo akuze penale kundër tij.”

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 06/L-074

Neni 406
(Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave)

“Kushdo që heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose të lokaleve, apo kushdo që hap

objektet e siguruara ose hyn në lokalet e tilla pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën apo shenjën, ose hap sendin në të cilin ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”

LIGJI Nr. 04/L-060 PËR MBETURINAT

Neni 73 (pa titull)

“Me gjobë në të holla prej dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro dënohet për kundërvajtje personi nëse:
[...]

1.20. nuk i dorëzon mbeturinat personave të licencuar për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. i këtij ligj;
[...]

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 57 (Mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar)

“1. I pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar:
1.1. nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses;
1.2. gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;
1.3. nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për veprë penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;
1.4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; dhe
1.5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për veprë penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtës”.

Neni 58 (Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar)

“1. Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse:
1.1 nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose
1.2. këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t`i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.
2. I pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit paraprak para se të merrret në pyetje për herë të parë.
3. Kërkesa për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të bëhet gjatë gjithë procedurës penale. Kryetari i gjykatës ose organi kompetent i cili zbaton procedurën në fazën paraprake vendos për kërkesën dhe cakton mbrojtës. Nëse policia ose prokurori i shtetit refuzon

kërkesën e të pandehurit për t'i caktuar mbrojtës me shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake.

4. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike sipas këtij neni, i pandehuri duhet të plotësojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohej se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

33. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 460/2021] e 11 janarit 2022, të Gjykatës Supreme

dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ1-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura ose të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*": (shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KIO4/21](#) parashtrues: *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafi 27, dhe rasti [KI75/20](#) parashtrues: *Rahman Rama*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 tetorit 2021, paragrafi 38; shih gjithashtu rastet GJEDNJ-së: [Kemmachev kundër Francës](#), kërkesa nr. [17621/01](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonisë](#), kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii).
37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit i referohen dënimit të parashtruesit të kërkesës për veprën penale të "*Heqjes ose dëmtimit të vulave ose shenjave zyrtare*", si dhe vërejtjen e lëshuar në procedurë për kundërvajtje për mosrespektim të masave në kryerjen e punëve të thertoresh, të cilat janë të parapara me lejen mjedisore të lëshuar nga Komuna e Lipjanit. Në procedurën penale, Gjykata Themelore e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale "*Heqja ose dëmtimi i vulave apo shenjave zyrtare*" nga paragrafi 1 i nenit 406 të KPRK-së dhe e gjobiti atë me 400 (katërqind) euro. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në fund, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së

parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë. Gjykata Themelore në procedurën paraprake e shpalli parashtruesin përgjegjës për mosrespektim të masave në kryerjen e aktiviteteve të thertores, të cilat janë të parapara me lejen mjedisore të lëshuar nga Komuna e Lipjanit, dhe për këtë arsye i është shqiptuar vërejtje gjyqësore. Në procedurën e kundërvajtjes, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ankesë.

39. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave nga gjykatat e rregullta të përcaktuara në nenin 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës; pastaj neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; si dhe neni 10 i DUDNJ-së.

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 30 të Kushtetutës

40. Prandaj, Gjykata do të shtjellojë më tej pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën e mbrojtjes në kuptim të garancive procedurale të garantuara me nenin 30 të Kushtetutës.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 5, neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 30
[Të Drejtat e të Akuzuarit]

*Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:
[...]
(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
[...]*

(i) Parimet themelore të së drejtës për mbrojtje sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

42. GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore ka ritheksuar “[...] edhe pse jo absolute, e drejta e secilit, i cili është akuzuar për një vepër penale që në mënyrë efektive të mbrohet nga një avokat është një nga veçoritë themelore të gjykimit të drejtë” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Salduz kundër Turqisë](#) [DHM], kërkesa nr. 36391/02, Aktgjykim i 27 nëntorit 2008, paragrafi 51, [Demebukov kundër Bullgarisë](#), kërkesa nr. 68020/01, Aktgjykim i 28 shkurtit 2008, paragrafi 50, [Ibrahim dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) [DHM], kërkesat nr. 50541/08, 50571/08, 50573/08 dhe 40351/09, Aktgjykim i 13 shtatorit 2016, paragrafi 255).
43. Sipas, GEDNJ-së, neni 6, paragrafi 3, pika c, përmban tri të drejta të ndryshme: (i) atë për t’u mbrojtur vetë; (ii) atë për të pasur ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur vetë dhe (iii) të ndihmës juridike falas nga një avokat (shih rastin [Pakelli kundër Gjermanisë](#), nr. 8398/78, Aktgjykim i 25 prillit 1983, paragrafi 31).
44. Marrë për bazë kontekstin e rastit konkret, Gjykata në vijim do t’i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me të drejtën për t’u mbrojtur vetë dhe të drejtës për ndihmë juridike falas.
45. Përkitazi me të drejtën për t’u mbrojtur vetë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përcakton se “[...] e drejta për t’u mbrojtur vetë nuk garantohet në mënyrë absolute. Çështja nëse të akuzuarit i lejohet për t’u mbrojtur vetë apo t’i caktohet një

avokat...është në varësi të legjislacionit vendor në fuqi apo rregullave të gjykatës përkatëse". Në këtë rast, shtetet anëtare gëzojnë hapësirë për vlerësim dhe janë në pozitë më të mirë për të zgjedhur mjetin që këshillohet në kuadër të sistemit të tyre gjyqësor për të garantuar të drejtat e mbrojtjes (shih rastin [Correia de Matos kundër Portugalisë](#) [DHM], nr. 56402/12, Aktgjykim i 4 prillit 2018, paragrafi 122).

46. Në këtë aspekt, GJEDNJ po ashtu ka vlerësuar se, i akuzuari mund të heqë dorë nga e drejta e tij për ndihmën e një avokati. Megjithatë, përpara se për një të akuzuar të mund të konstatohet se, me sjelljen e tij, ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga një e drejtë e rëndësishme që rrjedh prej nenit 6 të KEDNJ-së, duhet që të vërtetohet se ai kishte mundësi të arsyeshme për t'i parashikuar pasojat e veprimeve të tij (shih rastin [Pishchalnikov kundër Ruisë](#), nr. 7025/04, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009, paragrafi 77).
47. Në anën tjetër, përkitazi me të drejtën për ndihmë juridike falas, Gjykata vëren se GJEDNJ përcakton që e drejta për ndihmë juridike falas u nënshtrohet dy kushteve (shih rastin [Quaranta kundër Zvicrës](#), nr. 12744/87, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 27, [Caresana kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 31541/96, Vendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2000). Së pari, i akuzuari duhet të provojë pamundësinë e tij financiare dhe, së dyti, shtetet kontraktuese janë të detyruara të ofrojnë ndihmë juridike vetëm "kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë", të cilat duhet të vlerësohen duke marrë parasysh faktet e çështjes në tërësi (shih rastin e sipërcituar [Quaranta kundër Zvicrës](#), nr. 12744/87, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 27).
48. GJEDNJ, në rastet kur vendosë përkitazi me kriterin "kur interesat e drejtësisë e kërkojnë" që një të akuzuari t'i caktohet përfaqësim ligjor falas, ka përcaktuar edhe disa kriteret shtesë, të cilat, ndër të tjera përfshijnë seriozitetin e veprës penale dhe ashpërsinë e dënimit në fjalë. Në parim, GJEDNJ ka vlerësuar se kur privimi i lirisë është i mundur, interesat e drejtësisë kërkojnë përfaqësim ligjor (shih rastin [Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) [DHM], kërkesa nr. 19380/92, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 61; shih rastin e cituar më lart [Quaranta kundër Zvicrës](#), paragrafi 33). Si kriter tjetër i vendosur nga GJEDNJ është edhe kompleksiteti i rastit (shih rastin e cituar më lart [Quaranta kundër Zvicrës](#), paragrafi 34), si dhe situata personale e të akuzuarit [Zdravko Stanev kundër Bullgarisë](#), nr. 32230/04, Aktgjykim i 6 nëntorit 2012, paragrafi 38, shih, ngjashëm Gjykata Kushtetuese, rastin [KI140/18](#) parashtrues: *Naim Osmani*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2019, paragrafët 45-51 dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese: [KI14/21](#) parashtrues: *Shpejtim Hajrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 gushtit 2021, paragrafët 39-54).

(ii) Zbatimi i parimeve të mësipërme në rrethanat e rastit konkret

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin të cilin e ka paraqitur në Gjykatën Supreme në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ka përsëritur në Gjykatën Kushtetuese, thelbi i së cilës lidhet me faktin se Gjykata Themelore nuk i ka caktuar mbrojtje (avokat) as nuk e ka udhëzuar për mundësinë e angazhimit të mbrojtësit gjatë procedurës penale. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij si të akuzuar, të garantuar me nenin 30 të Kushtetutës.
50. Gjykata i referohet pjesëve përkatëse të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili, në lidhje me pretendimin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për të drejtën e mbrojtjes, arsyetoi: "Sa i përket pretendimit se i njëjti ka qenë person laik dhe se nuk ka qenë në gjendje që të ndërmarr veprime dhe të propozoj prova të cilat do të shkonin në favor, kjo Gjykatë me shikimin në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor P. nr. 446/2020 datë 13.04.2021, gjën se i njëjti në fillim të shqyrtimit është

udhëzuar se mund të mbrohet vet ose nëpërmjet mbrojtjes juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij, i njëjti i ka kuptuar të drejtat e tij me të cilat është njoftuar nga ana e gjykatës dhe se do të deklarohet për çështjen si dhe mbrojtjen do ta parashtrijë vetë. Pra i dënuari me vetë dëshirë ka heqë dorë nga mundësia që të ketë avokat mbrojtës, [...].

51. Gjykata më tej vëren se sa i përket të drejtës për mbrojtje të detyrueshme, Gjykata Supreme arsyetoi: “... gjykata nuk ka qenë e obliguar që të caktojë avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare meqenëse për këtë vepër penale nuk është paraparë mbrojtja e obligueshme”.
52. Prandaj, nga shtjellimet e lartpërmendura, bazuar në parimet e përgjithshme të përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur dhe vlerësimin e Gjykatës Supreme, i cili bazohet në rrethanat e rastit dhe dispozitat përkatëse të procedurës penale, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës së tij për mbrojtje, të garantuar me nenin 30 të Kushtetutës, janë qartazi të pabazuara.
53. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kushtet kryesore në lidhje me të drejtën e përfaqësimit ligjor falas, të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të mishëruara në nenet 57 dhe 58 të KPPRK-së, përkatësisht kushti i pamundësisë financiare dhe “kur kërkohet nga interesat e drejtësisë” angazhimi i një avokati mbrojtës me shpenzime publike, janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Gjykata Supreme. Gjithashtu, Gjykata Supreme ka vlerësuar edhe një kusht shtesë lidhur me mbrojtjen e detyrueshme të parashikuar në këtë procedurë penale, ku në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykata nuk ka qenë e detyruar të caktojë një avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare.
54. Prandaj, Gjykata, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe faktet që ai paraqiti, dhe bazuar në parimet e përgjithshme të vendosura në praktikën e GJEDNJ-së, theksoi se e drejta për një avokat mbrojtës nuk është absolute dhe se kjo e drejtë duhet të interpretohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe rrethanat specifike të rastit, ajo vlerëson se interpretimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme bazohet në ligj dhe në faktet e paraqitura pranë kësaj gjykate.
55. Prandaj, Gjykata përcakton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për mbrojtje, e cila është një element integral i të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bien në kategorinë e dytë (ii) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime me “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”, prandaj, të njëjtat, në baza kushtetuese, duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara.

II. Përkitazi me pretendimet për interpretim të gabuar të ligjit dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike

56. Parashtruesi i kërkesës konteston në Gjykatë gjetjet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar shkelje të Kushtetutës për shkak të interpretimit të gabuar të KPK-së dhe KPPK-së nga gjykatat e rregullta, duke deklaruar, “Aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare (neni 384, par. 1 pika 1.12 të KPPRK-së), kjo mund të shihet nga përmbajtja e arsyetimit, ku në fakt vetëm përmenden, e nuk sqarohet përmbajtja e tyre, përkatësisht aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 paragrafi 4 të KPPRK-së.
57. Duke shqyrtuar këto pretendime, Gjykata thekson se këto pretendime në esencë ndërliohen me zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, të

cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si *pretendime "të shkallës së katërt"*.

58. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafët 281 dhe 288), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: [KI96/21](#), parashtrues: *Xhelal Zherka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 49; [KI145/20](#), parashtrues: *Hafize Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 33; [KI179/18](#), parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
59. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së: [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61).
60. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës.
61. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aplikimin e gabuar të KPPK-së dhe KPK-së, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë "*qartazi i gabuar*", duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin

e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar të njëjtat (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI64/20](#), parashtruesi i kërkesës: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe [KI37/21](#) parashtrues të kërkesës: *Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 67).

62. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura dhe faktet e paraqitura nga nga parashtruesi i kërkesës, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta në lidhje me vendimin për dënim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e "shkallës së katërt" dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të "ligjshmërisë" dhe nuk janë argumentuar në nivel të "kushtetutshmërisë". Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

III. Përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

63. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit së kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ka të bëjë kryesisht me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor nga gjykatat e rregullta. Lidhur me këtë, Gjykata në vazhdim do t'i referohet parimeve të përcaktuara nga GJEDNJ, në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

(i) Parimet e përgjithshme për të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor

64. Në parim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet "të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre". Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih rastin e Gjykatës [KI07/18](#), parashtrues "Çeliku Rollers" d.o.o., Aktgjykim i 18 dhjetorit 2019, paragrafët 100 dhe 101).
65. Përkundër faktit që gjykatat e rregullta kanë një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ato janë të detyruara të justifikojnë veprimet e tyre duke arsyetuar të gjitha vendimet e tyre (shih rastet e GJEDNJ-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe Aktgjykimin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
66. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të jap arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30). Në nenin 6,

paragrafi 1 rrjedh detyrimi për gjykatat që të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastin e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).

67. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), të cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Ruisisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt është marrë me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së: [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më tepër e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
68. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77-83).
69. Neni 6, paragrafi 1 nuk e detyron Gjykatën Supreme që të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës, sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së: [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02, Vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë \(nr. 2\)](#), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi; shih rastin e Gjykatës [KI106/22](#), parashtrues [Driton Fetahu](#), Aktvendim i 8 shkurtit 2023, paragrafët 45-56).
70. Një tjetër funksion i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë vlerësim publik të administrimit të drejtësisë (shih, GJEDNJ, rasti [Tatishvili kundër Ruisisë](#), cituar më lart, paragrafi 58).
71. Përveç kësaj, e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshinë detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre me baza të arsyeshme, si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material. Dhënia e arsyeve kërkon shpjegime me arsye të besueshme dhe të mirëndërtuara në çdo rast individual, të cilat duhet të përfshijnë si kritere ligjore ashtu edhe elemente faktike në mbështetje të vendimit.
72. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet të sqarojë raportin ndërmjet gjetjeve në merita dhe vlerësimeve lidhur me provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara dhe dispozitat ligjore përkatëse, si dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastin e Gjykatës [KI72/12](#), parashtrues [Veton Berisha dhe Ilfete Haziri](#), Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012, paragrafët 53-61).

73. Gjykata e vlerësoi zbatimin e këtij parimi prej rasis në rast, në varësi të rrethanave specifike të rastit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kontestuara përmbushnin mjaftueshëm detyrimin për arsyetimin e vendimeve. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye, mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet duke pasur parasysh rrethanat e rastit (shih, GJEDNJ, rasti *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30).

(ii) Zbatimi i parimeve të sipërpërmendura në rrethanat e rastit konkret

74. Duke iu referuar pretendimeve në kërkesë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Arsyet janë plotësisht të paqarta, ngase egzistojnë në një masë e konsiderueshme kontradiktat e theksuara midis asaj çka paraqitet në arsyet e aktgjykimit, të cilat kundërthënje janë kontradiktore me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklarimet e dhëna në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit dhe dëshmitarëve në njërën anë, dhe perfundimet e nxjerra nga Gjykata në anën tjetër. Përfundimet e pretenduara të gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me provat e administruara, të cilat qojnë në një përfundim tjetër. Nuk ka analizë thelbësore në raport me institutin e DASHJES. Por analiza e pretenduar është e pergjithësuar, dhe nuk ka mbështetje në veprimet konkrete të raportit volutiv, pa të cilin edhe nuk ka përgjegjësi penale. Mungesa e një analize të tillë, në këtë dimension, paraqet shkelje esenciale të dispozitave procedurale, andaj aktgjykimi i atakuar nuk mund të qëndroj me qenë se përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, janë në kundërshtim me rezultatet nga provat e administruara”.*
75. Gjatë shqyrtimit të pretendimit kryesor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari i referohet pjesëve përkatëse të Aktgjykimit [P. nr. 446/20], të 15 prillit 2021, të Gjykatës Themelore, në të cilin e njëjta arsyetoi se: *“Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi edhe nga provat materiale, procesverbali nr. 01065 të dt. 05.08.2020, procesverbali nr. 01068 i dt. 10.08.2020 si dhe nga fotot e vendit të ngjarjes të dt. 20.08.2020 nga të cilat prova vërtetohet se fillimisht inspektoriat me ti konstatuar parregullsitë në teren tek biznesi në fjalë me dt. 05.08.2020 të njëjtit biznes i kanë vendosur shiritat e mbylljes së veprimtarisë, dhe pastaj me dt. 10.08.2020, pasi kanë dalur për ta kontrolluar biznesin në fjalë, është konstatuar nga ana e inspektorëve se shenjat zyrtare të vendosura janë hequr. Gjithashtu nga fotodokumentacioni shihet se shenjat zyrtare "Lokali mbyllet", është vendosur në hyrje të objektit dhe poashtu nga fotot tjera shihen mbeturina të therrtores të konstatuara në vendngjarje nga ana e inspektorëve ...”.*
76. Në këtë kontekst, Gjykata Themelore shton se: *“Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoi mbrojtjen e të akuzuarit, mirëpo të njëjtës mbrojtje nuk ia fali besimin me arsyetimin se i akuzuari kishte për qëllim vetëm për t’iu shmangur përgjegjësisë penale, sepse nga të gjitha provat e administruara, në mënyrë bindëse u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pra në mënyrë bindëse u vërtetua se i njëjti i ka hequr shenjat zyrtare të vendosura nga inspektorët e komunës së Lipjanit në fsh. Banullë, si rezultat i parregullsive të konstatuara ku, përveç veprës penale të akuzuar, akuzua ka mund të ngritet edhe ndaj biznesit të tij, dhe jo vetëm për këtë vepër penale por edhe për mbrojtje të mjedisit”.*
77. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, lidhur me gjobat e shqiptuara ndaj parashtruesit të kërkesës, arsyetoi si në vijim: *“Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata vlerësoi sjelljen para kryerjes së veprës penale,*

pra faktin se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sjelljen pas kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti nuk e ka përsëritur veprën penale, rrethanat personale, pra faktin se i njëjti është i moshuar dhe e ka gjendjen e rënduar shëndetësore, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale, pra faktin se i njëjti ka qenë plotësisht i aftë të kuptojë dhe kontrollojë veprimet e veta inkriminuese si dhe duke pasur për bazë intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së”.

78. Gjykata, duke iu referuar më tej pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit vetëm ka përsëritur arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore, vëren se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj [PA1. nr. 749/2021] të 12 tetorit 2021, arsyetoi si në vijim: *“Përkundër asaj që sipas ankesës së të akuzuarit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga provat e administruara nga shkresat e lëndës, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK-së, dhe si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar sjelljen e të akuzuarit para kryerjes së veprës penale, se është hera e parë që i njëjti ka ra në kundërshtim me ligjin, se i njëjti nuk e ka përsëritur më veprën penale, se i njëjti është i moshuar, se ka gjendjen e rëndë shëndetësore, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprave penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave. Nga ankesa e të akuzuarit Rizah Rrustemi, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit ose personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.”*
79. Në vijim të kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore dhe të Apelit. Megjithatë, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetimin si në vijim: *“[...] duke vlerësuar pretendimet e të dënuarit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, gjen se aktgjykimi i shkallës së parë respektivisht dispozitivi i tij është i qartë, i kuptueshëm dhe i njëjti nuk është në kundërtënie as me vetveten e as me arsyetimin e aktgjykirnit. Në arsyetim të këtij aktgjykimi janë dhënë të gjitha arsytet ligjore për faktet dhe provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor, duke i përfshirë edhe provat kontradiktore si dhe duke dhënë arsytet ligjore se për çfarë arsytet i ka dhënë besimin provave dhe fakteve vendimtare mbi bazën e të cilave është marrë vendimi meritor në këtë çështje penale. Kjo gjykatë gjen se edhe gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsytet të mjaftueshme dhe se i ka pranuar të gjitha arsytet mbi bazën e të cilave është marrë vendimi e të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kështu nga shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari Rizah Rrustemi është pronar i therrtores BI, me seli në fshatin Banullë, komuna e Lipjanit, dhe se gjatë një kontrolli është vërtetuar se mbetjet e kafshëve të therrtura nuk ia dorëzon kompanive të cilësuarat për menaxhimin e këtij lloji mbeturinash po ato i hedh në një gropë të rregulluar vetë dhe 1 km. larg nga thertorja. Të njëjtën ditë me datën 05.08.2020 siç vërtetohet nga procesverbali për kontrollimin inspektues të njëjtit i është mbyllur biznesi dhe është*

obliguar që t'i eliminojë shkeljet e gjetura ndërsa me datën 10.08.2020 në procesverbal është konstatuar se i njëjti i ka larguar shenjat zyrtare të vendosura nga ana e Inspektoratit e për çka në shkresat e çështjes ekziston edhe foto dokumentacioni i cili është administruar si provë. Më tutje, i dënuari edhe pse pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.8 të KPPK-së, pra duke u bazuar në prova të papranueshme nuk e argumenton këtë pretendim andaj edhe gjykata nuk e shqyrtoi të njëjtin. Sa i përket pretendimit se i njëjti ka qenë person laik dhe se nuk ka qenë në gjendje që të ndërmarr veprime dhe të propozoj prova të cilat do të shkonin në favor kjo Gjykatë me shqimin në procesverbalin'e shqyrtimit gjyqësor P. nr. 446/2020 datë 13.04:2021, gjen se i njëjti në fillim të shqyrtimit është udhëzuar se mund të mbrohet vet ose nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij i njëjti i ka kuptuar të drejtat me të cilat është njoftuar nga ana e gjykatës dhe se do të deklatohet për çështjen si dhe mbrojtjen do ta parashtrorë vet. Pra, i dënuari me vetë dëshirë ka heq dorë nga mundësia që të ketë avokat mbrojtës ndërkaq gjykata nuk ka qenë e obliguar që të caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare meqenëse për këtë vepër penale nuk është paraparë mbrojtja e obligueshme”.

80. Gjykata, në bazë të sa më sipër, vlerëson se të gjitha pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, të cilat ai i ka paraqitur në kërkesën pranë Gjykatës Themelore dhe ankesën në Gjykatën e Apelit, janë shqyrtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të plotë nga ato gjykata. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se konkluzionet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit janë nxjerrë pas një shqyrtimi të detajuar të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga ato gjykata është brenda standardeve të një gjykimi të drejtë dhe parimeve të vendosura nga GJEDNJ dhe Gjykata për të drejtën për një vendim të arsyetuar.
81. Gjithashtu, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton se, kur bëhet fjalë për ligjshmërinë e vendimeve të shkallës së ulët, Gjykata e Apelit, në parim, mund të pranojë thjesht arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe kjo në vetvete nuk bie ndesh me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së (shih, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, cituar më lart, paragrafi 26). Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se fakti se konkluzionet e Gjykatës Themelore janë pranuar edhe nga Gjykata e Apelit si të sakta dhe ligjore, nuk do të thotë se përmbajtja e arsyetimit të vendimit të saj është dashur të duket ndryshe. Për më tepër, Gjykata e Apelit, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, arsyetoi se në rastin konkret nuk ka shkelje të ligjit.
82. Gjykata rithekson se neni 6 i KEDNJ-së nuk e detyron gjykatën më të lartë që të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës, sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së: [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02, Vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë \(nr.2\)](#), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41; shih rastin e Gjykatës [KI106/22](#), parashtrues [Driton Fetahu](#), Aktvendim i 8 shkurtit 2023, paragrafët 45-56).
83. Sa i përket pretendimeve lidhur me aktgjykimin e kontestuar, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka dhënë arsye të bazuar në ligj, duke shpjeguar se përse në rastin konkret kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës është dashur të refuzohet si e pabazuar. Gjykata Supreme rikujtoi se situata u vërtetua në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe bazuar në faktin se aktgjykimet nuk ishin të përfshira në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ligji penal u zbatua siç duhet kur parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor për veprën e cila iu ngarkua atij. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konkludon se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban

arsyetimin e nevojshëm sepse tregon qartë arsyet e pabazueshmërisë së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

84. Gjykata thekson se neni 6 i KEDNJ-së, në një proces gjyqësor, nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm, sepse njera prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI118/17](#), *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe [KI142/15](#), parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43, dhe [KI125/21](#), parashtrues *Armend Osaj*, Aktvendim i 11 majit 2022, paragrafi 73).
85. Fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës dhe përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të rregullta, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, rastin e Gjykatës, [KI136/14](#), parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
86. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka vërtetuar pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së bien në kategorinë e dytë (ii) të pretendimeve të cilat kategorizohen si pretendime me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, prandaj të njëjtat në baza kushtetuese duhet të deklarohen qartazi të pabazuara.

IV. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e të drejtës për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, të garantuar me nenin 34 të Kushtetutës

87. Gjykata do të shtjellojë më tej pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën e mbrojtjes përsa i përket garancive procedurale të garantuara me nenin 34 të Kushtetutës.
88. Gjykata i referohet nenit 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës, i cili përcakton:
“Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale”.
89. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 1 të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, i cili përcakton:
“1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti”.
90. Qëllimi i nenit 34 të Kushtetutës dhe i nenit 4 (1) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së duhet të parandalojë gjykimin e dyfishtë ose dënimin për të njëjtën sjellje të paligjshme. Megjithatë, këto dispozita nuk ndalojnë një qasje të integruar ndaj sjelljeve të dëmshme shoqërore, përkatësisht një qasje që nënkupton zhvillimin e disa procedurave paralele për të njëjtën sjellje të paligjshme nga organe të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme (shih rastin e GJEDNJ-së: [A. dhe B. kundër Norvegjisë](#) nr. 24130/11 dhe 29758/11 vendimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 123). Në këtë rast, GJEDNJ zbatoi tre elementë të parimit *ne bis in idem* të zhvilluar në praktikën e saj gjyqësore.

(i) Tri elementet e parimit ne bis in idem, të përcaktuar nga GJEDNJ-ja

(a) A janë të dyja procedurat e natyrës penale?

91. Me rastin e përcaktimit nëse dy procedurat ishin të natyrës penale, GJEDNJ vendosi tre kritere, të njohura zakonisht si “*kriteret Engel*” (rasti i GJEDNJ-së: [Engel dhe të tjerët kundër Holandës](#), vendim i 23 nëntorit 1976), të cilat duhet që të merren parasysh kur përcaktohet nëse ka pasur apo jo “*akuzë për veprë penale*”. Kriteri i parë është klasifikimi ligjor i veprës në bazë të ligjit kombëtar, i dyti është vetë natyra e veprës penale dhe i treti është ashpërsia e dënimit të cilit mund t'i nënshtrohet personi në fjalë. Kriteri i dytë dhe i tretë janë alternativë dhe jo domosdoshmërisht kumulative. Megjithatë, kjo nuk përjashton një qasje kumulative kur analiza e veçantë e secilit kriter nuk lejon arritjen e një përfundimi të qartë për ekzistencën e një akuze penale (shih rastet e GJEDNJ-së: [Jussila kundër Finlandës](#) nr. 73053/01, vendimi i 23 nëntorit 2006, paragrafi 30. -31., [Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) nr. 39665/98 dhe 40086/98 vendim i 9 tetorit 2003, paragrafët 82-86).

(b) Nëse dyja procedurat kishin të bënin me të njëjtat fakte (idem)?

92. Neni 4 i Protokollit nr. 7 ndalon ndjekjen penale ose gjykimin për një “*veprë*” tjetër në masën që rrjedh nga faktet identike ose fakte që janë në thelb të njëjta. Për të përcaktuar nëse faktet në të dyja procedurat ishin identike apo në thelb të njëjta, GJEDNJ merr parasysh ato fakte që përfaqësojnë një sërë rrethanash faktike konkrete që përfshijnë të njëjtin të pandehur dhe të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht në kohë dhe hapësirë, dhe ekzistenca e të cilave duhet të provohet për të siguruar aktgjykimin dënues ose fillimin e procedurës penale (shih rastin e GJEDNJ-së: [Sergey Zolotukhin kundër Rusisë](#) nr. 14939/03, vendim i 10 shkurtit 2009, paragrafët 82 – 84).

93. Garancia e përfshirë në nenin 4 të Protokollit nr. 7 bëhet e rëndësishme pas fillimit të një ndjekjeje të re penale, kur aktgjykimi i mëparshëm liruës ose dënues tashmë është bërë *res judicata*. Në këtë moment, materiali i disponueshëm do të përmbajë domosdoshmërisht vendimin përmes të cilit u përfundua “*procedura e parë penale*” dhe listën e akuzave ndaj parashtruesit të kërkesës në procedurën e re. Zakonisht këto dokumente do të përmbajnë deklaratatë të faktit që kanë të bëjnë si me veprën penale për të cilën parashtruesi i kërkesës tashmë është gjykuar, po ashtu edhe me veprën për të cilën ai ose ajo akuzohet. Sipas mendimit të gjykatës, deklaratatë të tilla të fakteve përfaqësojnë një pikënisje adekuate për përcaktimin e çështjeve nëse faktet në të dyja procedurat ishin identike ose në thelb të njëjta. Gjykata thekson se është e parëndësishme se cilat pjesë të akuzave të reja do të konfirmohen ose refuzohen në procedurën e mëpasshme, sepse neni 4 i Protokollit nr. 7 ndalon dënime ose lirime tjera.

94. Prandaj, në shqyrtimin e saj, gjykata duhet të përqendrohet në ato fakte që përfaqësojnë një sërë rrethanash faktike konkrete që përfshijnë të njëjtin të pandehur dhe që janë të lidhura pazgjidhshmërisht në kohë dhe hapësirë, dhe ekzistenca e të cilave duhet të provohet për të siguruar një aktgjykim dënues ose për të filluar procedurën penale.

(c) A ka pasur dyfishim të procedurave? (bis)?

95. Në mënyrë që Gjykata të bindet se nuk ka pasur dyfishim të procedurave, parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se të dyja procedurat janë “*të ndërlidhura mjaftueshëm në natyrë dhe kohë*”. Me fjalë të tjera, duhet të vërtetojë se procedurat janë kombinuar në tërësi, në mënyrë që të krijojnë një tërësi të lidhur. Kjo tregon jo vetëm faktin se

qëllimet që tentohen të arrihen dhe mënyrat se si ato arrihen duhet të jenë në thelb plotësuese dhe të lidhura në kohë, por edhe se pasojat e mundshme të një organizimi të tillë të procedurave ligjore në lidhje me sjelljen e kontestuar duhet të të jenë të arsyeshme dhe të parashikueshme për personat që janë prekur nga to (shih, [A. dhe B. kundër Norvegjisë](#), paragrafi 130 i cituar më lart).

96. Në mënyrë që të dyja procedurat të konsiderohen mjaftueshëm të lidhura në natyrë dhe kohë dhe në këtë mënyrë të përmbushin kriterin *bis* nga neni 4 i Protokollit nr. 7 duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme ([A. dhe B. kundër Norvegjisë](#) cituar më lart, paragrafi 132).
- përmes procedurave të ndryshme duhet të arrihen qëllime plotësuese dhe në këtë mënyrë të përfshijnë, jo vetëm “*in abstracto*”, por edhe “*in concreto*”, aspekte të ndryshme të sjelljeve të kontestuara të papranueshme shoqërore;
 - zhvillimi i të dyja procedurave për të njëjtën sjellje duhet të jetë e parashikueshme, si në ligj ashtu edhe në praktikë (“*idem*”);
 - ato procedura duhet të kryhen në atë mënyrë që të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur dyfishimi në mbledhjen dhe vlerësimin e provave, kryesisht përmes bashkëpunimit të duhur ndërmjet organeve të ndryshme kompetente në mënyrë që faktet e vërtetuara në një procedurë të mund të përdoren në një procedurë tjetër;
 - dënimi i shqiptuar në procedurën që fillimisht ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm duhet të merret parasysh në procedurën që më vonë ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm, duke e penguar kështu përfundimisht që individi të bartë një barrë të tepruar. Ky rrezik do të reduktohet nëse ekziston një mekanizëm për të siguruar që shuma e përgjithshme e të gjitha sanksioneve të jetë proporcionale.

(ii) Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastin konkret

97. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës së tij për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën veprë penale të garantuar me nenin 34 të Kushtetutës, sepse vendimi për përgjegjësinë e tij penale është bazuar në të njëjtat fakte si vendimi për përgjegjësinë në procedurën e kundërvajtjes.

(a) Nëse dy procedurat e ngritura kundër parashtruesit të kërkesës janë të natyrës penale?

98. Sipas klasifikimit ligjor vendas, vepra e përcaktuar si “*kundërvajtje*” përfshin disa vepra që kanë konotacion penal, por janë shumë të parëndësishme për t’u zbatuar ndaj tyre ligji penal.
99. Për nga natyra e tyre, përfshirja e kundërvajtjeve kundër rendit dhe qetësisë publike në Ligjin për Kundërvajtje shërben si garanci për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe rendit publik, të cilat janë vlera dhe interesa që, si rregull, bien nën mbrojtjen e së drejtës penale. Dispozitat përkatëse të atij Ligji i referohen të gjithë qytetarëve dhe jo një grupi që ka pozitë të veçantë. Referimi i natyrës “*më të lehtë*” (kundërvajtëse) të veprës në vetvete nuk përjashton klasifikimin e tyre si “*penale*” në kuptimin autonom të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, pasi nuk ka asgjë në Kushtetutë, si dhe në KEDNJ, që do të çonte në përfundimin se natyra e veprës penale, sipas kriterit *Engel*, kërkon domosdoshmërisht një shkallë të caktuar të peshës (shih rastin e cituar më sipër [Ezeh dhe Connors](#) kundër Mbretërisë së Bashkuar, para. 104). Në fund, Gjykata vlerëson se qëllimi parësor i paraqitjes së këtyre veprave është ndëshkimi dhe parandalimi, dhe këto janë kuptimet e njohura të veçorive të sanksioneve penale.
100. Për sa i përket shkallës së seriozitetit të masës, ajo përcaktohet në bazë të dënimit maksimal të mundshëm të parashikuar me ligjin përkatës. Dënimi i shqiptuar në të

vërtetë është i rëndësishëm për vendimin, por nuk mund të zvogëlojë rëndësinë e asaj që fillimisht ishte në pyetje. Gjykata vëren se Ligji për Mbeturinat bazuar në nenin 73, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20, parasheh gjobë deri në 5000 (pesë mijë) euro dhe se parashtruesit i është dhënë një vërejtje në fund. Siç e ka konfirmuar në mënyrë të përsëritur Gjykata, në një shoqëri që mbështet sundimin e ligjit, ku dënimi që do t'i shqiptohet në të vërtetë parashtruesit të kërkesës përfshin humbjen e lirisë, ekziston një supozim se akuzat kundër parashtruesit të kërkesës janë "penale", supozim që mund të kundërshtohet plotësisht në raste të jashtëzakonshme, dhe vetëm nëse heqja e lirisë nuk mund të konsiderohet "shumë e dëmshme" për shkak të natyrës, kohëzgjatjes ose mënyrës së kryerjes të tyre (shih rastin e GjEDNJ-së: [Engel dhe të tjerët](#), par. 82, dhe [Ezeh dhe Conors](#), par. 126, të cituar më sipër). Në rastin e parashtruesit të kërkesës, në asnjë fazë të procedurës nuk ka pasur humbje të lirisë dhe as nuk është shqiptuar një masë e tillë.

101. Në dritën e sa më sipër, Gjykata konkludon se natyra e veprës penale kundër rendit dhe qetësisë publike, së bashku me ashpërsinë e dënimit, çuan në dënimin/qortimin e parashtruesit të kërkesës përmes Aktgjykimit [K. nr. 3099/21] të 18 janarit 2021 si pjesë e "procedurës kundërvajtëse" në kuptim të nenit 4 të Protokollit nr. 7.

(b) Nëse dy procedurat e iniciuara kundër parashtruesit të kërkesës kishin të bënin me të njëjtat fakte (*idem*)?

102. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, nuk ka dyshim se procedurat për kundërvajtje dhe penale janë zhvilluar për shkak të parregullsive në punën e subjektit afarist në pronësi të parashtruesit të kërkesës. Këto parregullsi janë konstatuar nga shërbimi inspektues në gusht 2020. Në procedurën e kundërvajtjes, parashtruesi i kërkesës ishte dënuar për shkak se ka bërë shkelje të nënparagrafit 1.20 të paragrafit 1 të nenit 73 të Ligjit për Mbeturina, për shkak të deponimit të pandërgjegjshëm dhe mosdorëzimit të mbeturinave personave të licencuar për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, ndërsa në procedurën penale, bazuar në paragrafin 1 të nenit 406 të KPRK-së, ishte dënuar me gjobë për veprën penale të kryer të heqjes ose dëmtimit të vulave ose shenjave zyrtare.

103. Faktet për të cilat parashtruesi i kërkesës është dënuar në procedurë për kundërvajtje bazuar në nënparagrafin 1.20 të paragrafit 1 të nenit 73 të Ligjit për mbeturina nuk mund të konsiderohen në thelb të njëjta me faktet për të cilat parashtruesi i kërkesës është dënuar më vonë në një procedurë penale. Prandaj, në lidhje me këtë kundërvajtje, Gjykata nuk do të shqyrtojë kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e parimeve *ne bis in idem*.

104. Nuk kishte mbivendosje të fakteve nga kundërvajtja dhe vepra penale nga paragrafi 1 i nenit 406 të KPRK-së. Në të vërtetë, vepra penale e deponimit të pandërgjegjshëm dhe mosdorëzimi i mbeturinave personave të licencuar për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave është kundërvajtje "më e lehtë" se vepra penale e heqjes apo dëmtimit të vulave apo shenjave zyrtare. Kundërvajtja që përfshin deponim të pandërgjegjshëm dhe mosdorëzim të mbeturinave dhe disa fakte shtesë për të cilat parashtruesi i kërkesës nuk mund të dënohet në procedurë penale (për heqjen ose dëmtimin e vulave ose shenjave zyrtare). Me fjalë të tjera, nëse kundër tij nuk është iniciuar procedura penale, parashtruesi i kërkesës nuk do të ishte dënuar për tërë sjelljen e tij.

105. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta mund të zgjedhin në mënyrë legjitime përgjigje ligjore plotësuese ndaj sjelljeve të papranueshme shoqërore përmes procedurave të ndryshme që formojnë një tërësi të lidhur, me qëllim të zgjidhjes së aspekteve të ndryshme të një problemi të caktuar shoqëror, me kusht që

grupi i këtyre përgjigjeve ligjore nuk përfaqëson një barrë të tepërt për individin të cilit i referohen (shih, [A. dhe B. kundër Norvegjisë](#), cituar më lart, par. 123).

106. Megjithatë, edhe kur mbivendosja e fakteve është vetëm e pjesshme, ndarja e procedurave bartë rrezikun e gjykimit të dyfishtë ose të dënimit, gjë që është në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*. Prandaj, edhe në raste të tilla, Gjykata duhet të sigurohet që të mos ketë dyfishim të procedurave.

(c) *A ka pasur dyfishim të procedurave (bis)?*

107. Në rastin konkret të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se procedurat kundërvajtëse dhe penale përfshinin aspekte të ndryshme të sjelljes së paligjshme dhe synonin të arrinin qëllime plotësuese. Përkatësisht, qëllimi i procedurës për kundërvajtje ishte ndëshkimi/qortimi i parashtruesit të kërkesës për mosrespektim të rregullave, përkatësisht, për shkak të mosrespektimit të masave mjedisore në kryerjen e veprimtarive të thertores të parashikuara me leje mjedisore, ndërsa qëllimi i procedurës penale ishte ndëshkimi i parashtruesit të kërkesës për veprën penale të kryer të heqjes ose dëmtimit të vulave ose shenjave zyrtare nga paragrafi 1 i nenit 406 të KPRK-së.
108. Më tej, parashtruesi i kërkesës mund të priste që kundër tij do të fillonin dy procedura për shkak të veprimeve të paligjshme në fjalë. Përkatësisht, sipas legjislacionit pozitiv, vepra penale e heqjes apo dëmtimit të vulave apo shenjave zyrtare nga paragrafi 1 i nenit 406 i KPRK-së nuk mund të procedohej në procedurë kundërvajtëse, prandaj kombinimi i procedurës së kundërvajtjes me atë penale është i zakonshëm për shqiptimin e sanksioneve për mosrespektim të rregulloreve mjedisore dhe veprës penale të heqjes ose dëmtimit të vulave zyrtare.
109. Gjykata vlerësoi se ekzistonte një nivel i duhur bashkëpunimi ndërmjet dy gjykatave në të dyja procedurat lidhur me mbledhjen dhe vlerësimin e provave dhe vërtetimin e fakteve. Në procedurën penale, Gjykata Themelore ka përdorur prova të caktuara të paraqitura në Gjykatën Themelore në procedurën për kundërvajtje dhe ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të asaj gjykate.
110. Gjithashtu, dënimet e shqiptuara ishin proporcionale me peshën e veprës së kryer. Në të vërtetë, edhe pse në aktgjykimin penal nuk është marrë parasysh shprehimisht dënimi i shqiptuar në aktgjykimin për kundërvajtje, parashtruesit të kërkesës i është shqiptuar vërejtje, ndërsa dënimi maksimal i atëhershëm për deponimin e pakujdesshëm dhe mosdorëzimin e mbeturinave personave të licencuar ka qenë deri në 5000 (pesë mijë) euro. Prandaj, ky dënim nuk ishte qartë një barrë e tepruar për parashtruesin e kërkesës.
111. Në fund, Gjykata vëren se këto dy procedura janë iniciuar pothuajse në të njëjtën kohë (procedura për kundërvajtje është iniciuar më 16 gusht 2020, ndërsa aktakuza në procedurë penale është ngritur më 20 gusht 2020), dhe më pas kanë vazhduar paralelisht për gati 14 (katërmëdhjetë) muaj, deri në nëntor 2021, kur u nxor aktgjykimimi në procedurën e kundërvajtjes. Procedura penale zgjati 2 muaj më shumë, periudhë e cila, sipas Gjykatës, nuk ishte e paarsyeshme pasi që procedura penale është më e ndërlikuar se ajo e kundërvajtjes dhe është zhvilluar në tri shkallë të juridiksionit.
112. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ai është gjykuar dy herë për të njëjtën veprë penale, duke shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 34 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së hyn në kategorinë e dytë (ii) të pretendimeve të cilat kategorizohen si

pretendime me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, dhe për këtë arsye ato duhet të deklarohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

V. Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 10 të DUDNJ-së

113. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 10 të DUDNJ-së, Gjykata rikujton se sipas praktikës së përcaktuar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin e pretendimeve (iii) “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” edhe në rastet kur plotësohet një nga dy kushtet e mëposhtme karakteristike:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih rastin e GJEDNJ-së: [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03 i 31 majit 2005);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës: [K166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42.).
114. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht pretendon shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 10 të DUDNJ-së, por nuk i arsyeton ato, përkatësisht nuk shpjegon fare se si ka ardhur deri te shkelja e kësaj të drejte në rastin e tij. Prandaj, Gjykata vlerëson se në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet e sipërpërmendura, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, pasi këto kërkesa cilësohen si kërkesa që i përkasin kategorisë (iii) së kërkesave “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi disa dispozita të Kushtetutës dhe DUDNJ-së, pa arsyetuar se si ato janë shkelur.

Përfundim

115. Si përmbledhje, Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, përfundon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës:
- i. për shkelje të nenit 30 të Kushtetutës i përkasin kategorisë së dytë (ii) të pretendimeve që cilësohen si pretendime me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, dhe për rrjedhojë, në baza kushtetuese, këto pretendime deklarohen si qartazi të pabazuara;
 - ii. për interpretim të gabuar të ligjit dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike hyjnë në kategorinë e parë (1) të pretendimeve që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*” dhe për rrjedhojë, në baza kushtetuese, këto pretendime gjithashtu deklarohen si qartazi të pabazuara;
 - iii. për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, hyjnë në kategorinë e dytë (ii)

të pretendimeve që cilësohen si pretendime me “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”, prandaj, në baza kushtetuese, të njëjtat duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara;

iv. për shkelje të neneve 24 të Kushtetutës dhe 10 të DUDNJ-së kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) së pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara”.

v. për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës në lidhje me paragrafi 1 të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së hyjnë në kategorinë e dytë (ii) të pretendimeve të cilat kategorizohen si pretendime me “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”, dhe për këtë arsye ato duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

116. Prandaj, kërkesa në tërësi, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 nëntor 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani